

VENDIM
Nr. 296, datë 20.4.2016

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 12 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Kontrollit të Lartë të Shtetit.
 2. Lista me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1 (një) dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

[illegible]